

**Drejtuar:**

**Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës**

Në bazë të vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, nr.19-171/2 nga mbledhja e mbajtur më 07.06.2021, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: “Analiza e golave të shënuar në Premier Ligën Angleze, Serie-A Italiane, La Liga Spanjolle, Superligën Turke dhe Bundesligën Gjermane në gjysmën e parë të sezonit 2016-2017, dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019” i kandidatit Mr.Sc.Aytekin Sonmeyer-makas, u formua komisioni në përbërje: Prof. Dr. Haki Ismaili- kryetar, Prof. Dr. Shpresa Memishi - anëtare, Prof. Dr. Besnik Telai-anëtar, Prof. Dr. Vullnet Ameti - anëtar dhe Prof. Dr.Metin Dalip – anëtar. Komisioni, pasi e lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike ia paraqet këtë:

**RAPORT**

**për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës**

**Të dhënat biografike të kandidatit:**

Mr. Aytekin Sönmeyer-makas ka lindur në Edrene, më 21 shtator të vitit 1977. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në vendlindje, ndërsa fakultetin në Universitetin e Trakisë, në Institutin e Shëndetit dhe Kulturës Fizike në vitin 2002. Në vitin 2008 ka mbaruar studimet e ciklit të dytë dhe ka fituar titullin shkencor *magjistër i shkencave sportive në analizën e futbollit.*

### **Përvoja personale:**

Ai aktualisht është i angazhuar si bashkëpunëtor i lartë në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Edukimit Sportiv në Fakultetin e Shkencave të Sportit në Universitetin e Trakisë në Turqi, ku jep lëndët: Analiza e konkurseve të sporteve ekipore dhe Përdorimi i kamerave në sportet ekipore. Ai gjithashtu është i angazhuar në qendrën për trajnimin e trajnerëve në zonën e Trakisë në kuadër të Federatës së Futbollit të Turqisë.

Ka punuar për një numër të madh skuadrash nga Superliga e Futbollit të Republikës së Turqisë. Përvojat e tij në këtë fushë janë si vijojnë:

2020-2021 -analist dhe trajner në ekipin - Eskişehirspor

2019- analist dhe trajner në ekipin Edirnesport A

2016-2017 - analist dhe trajner në Gaziantep Büyükşehir Belediye (Turkey Tff I-League)

2016-2019 - profesor i lëndës Analiza e konkurrencës në Universitetin e Trakisë, Universitetin Kirkpinar në Fakultetin Edukimi Fizik dhe në Akademinë e Sporteve

2015-2016 - analist dhe trajner i performancës në Sivassport A (Superliga e Turqisë)

2014-2015 - specialist i analizës në FC Khazar Lankaran (Azerbajxhan - Premier Ligë).

2013-2014 - specialist analize në Universitetin Anadolu Üsküdar1908

2011-2012 - trajner dhe specialist analize në Siirt Jetpasport

03.10.2010 -2011 trajner dhe specialist për analizë të xhirimit të futbollit me kamera në Fenerbahçe Sk \_ (Football Youth Set Up)

31.03.2008- 2010 - trajner i gjyqtarëve të futbollit elitar në (TFF) Federata e Futbollit të Turqisë Qendra e Zhvillimit të Futbollit Elitar.

2007-2008 trajner në Universitetin e Shkencave Teknike të Trakisë si dhe koordinator sportiv në Akademinë e Sportit të Universitetin e Kirpinarit.

2007- 2008 - trajner i ekipit të femrave në futsal në Universitetin e Trakisë

2007- 2008 - trajner i shkollës së futbollit - Edirne Galatasaray.

2004-2005 - trajner në Edirne Ptt Sport Football School and Youth Set Up  
Coordination

1999 - 2001 - trajner i shkollës së futbollit - Edirne Fenerbahçe.

**Punimet shkencore të publikuara në revistat shkencore kombëtare dhe  
ndërkombëtare:**

- Agat G., Taşkın C., Canlı U., Ayyıldız E., Sönmeyenmakas A., Taşkın Y. (2021) Pandemide Ortaokul Öğrencilerinin Uzaktan Eğitimde Beden Eğitimi ve Spor Dersine İlgili Düzeyleri, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye(Mayıs 2021)
- Gündüz F., Canlı T., Canlı U., Ayyıldız E., Taşkın C., Sönmeyenmakas A. (2021) Takım Sporcuları ve Mücadele Sporcularının Antrenör-Sporcu İlişkisinin Karşılaştırılması, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021)
- Taşkın Y., Mert N., Taşkın C., Sönmeyenmakas A., Canlı U. (2021) Sınıf Öğretmenlerinin Beden Eğitimi Derslerinde Karşılaştıkları Problemlerin İncelenmesi, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021)
- Denkel M., Taşkın C., Canlı U., Ayyıldız E., Sönmeyenmakas A., Taşkın Y. (2021) Ortaokul Öğretmenlerinin Okul İkliminde Tutum ve Davranışlarının Değerlendirilmesi, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021).
- Çelik I., Canlı U., Ayyıldız E., Sönmeyenmakas A., Taşkın C. (2021) Antrenörlük Mesleğine Yönelik Tutumların İncelenmesi, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021) (Mayıs 2021)

- Yıldırım M., Taşkın C., Canlı U., Ayyıldız E., Sönmeyenmakas A. (2021) Pandemi Döneminde Aktif Olarak Spor Yapan Sedanter Bireylerin Psikolojik İhtiyaçları Üzerine Bir Araştırma, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021)
- Demirel S., Taşkın C., Canlı U., Ayyıldız E., Sönmeyenmakas A. (2021) Sporla ilgilenen üniversite öğrencilerinin zihinsel dayanıklılık durumlarının incelenmesi: Tekirdağ Namık Kemal Üniversitesi Beden Eğitimi ve Spor Yüksekokulu Örneği, 13.Ulusal Spor Bilimleri Öğrenci Kongresi, 27-29 Mayıs, Kastamonu, Türkiye (Mayıs 2021)
- Taşkın Cüneyt, İlğaz Gökhan, Sönmeyenmakas Aytekin, Canlı Umut (2018). Beden eğitimi ve spor öğretmenliği programları için bilişim teknolojileri ihtiyaç analizi. 6. Uluslararası Öğretim Teknolojileri ve Öğretmen Eğitimi Sempozyumu (ITTES 2018) (Tam Metin Bildiri/Sözlü Sunum)
- Badminton Patlayıcılık Özellikleri (2017)., TAŞKIN CÜNEYT, Lambert Academic Publishing, Editör: Sönmeyenmakas Aytekin, Basım sayısı:1, ISBN:978-620-2-02153-1, Türkçe
- Futbol Analiz: Gol Analizi (2017), Sönmeyenmakas Aytekin, Lambert Academic Publishing, Editör: Cüneyt Taşkın, Basım sayısı: 1, 978-620-2-05819-3
- Sosyospor: Bölüm adı: ( Spor ve Pedagoji ) (2021).Sönmeyenmakas Aytekin, Gazi Kitabevi, Editör: Şuta Cüneyt, Sönmeyenmakas Aytekin, Özen Tufan, Basım sayısı:1 ISBN:9786257358040
- Rekreasyon Paradigması, Bölüm adı: (Sosyal Medya Unsurları ve Boş Zaman) (2020). Sönmeyenmakas Aytekin, Gazi Kitabevi, Editör: Taşkın Cüneyt, Basım sayısı:1 ISBN:9786257855112
- Sönmeyenmakas, A., Analysis of Goals Scored in the League of England, Italy, Spain, Turkey, Germany at the 1st Circuit of 2016-2017 Season ERPAInternational Congresses on Education 2017 Budapest/Hungary 18-21 May 2017

- Sönmeymenmakas, A. (2008). UEFA Şampiyonlar Liginde Atılan Gollerin Analizi, Trakya Üniversitesi Sağlık Bilimleri Enstitüsü Beden Eğitimi ve Spor Anabilim Dalı Yüksek Lisans Tezi, Edirne
- Champions League Laidanalysis of Goals Aytekin Sönmeymenmakas, Metin Dalip Trakya University, Kırkpınar Scholl of Physical Education and Sport 2State University of Tetova, Faculty of Physical Educatio. International Balkan Symposium in Sport Sciences IBSSS 20131 th Balkan Symposiummacedonia 2013

### **Analiza e disertacionit të doktoratës:**

**Kapitulli i parë (Hyrja)** -Sot, në botë futbolla konsiderohet si një nga sportet më të njohura. Dihet se kuptimi i lojës në futboll ndryshon sipas vendeve dhe ligave, si dhe për mënyrat e ndryshme që aplikohen për të arritur drejt suksesit.

Vitet e fundit, ka një përpjekje për të gjetur përgjigje në pyetjet se në çfarë niveli janë paraqitjet e ndeshjeve të skuadrave dhe lojtarëve dhe si duhet të përcaktohet kjo paraqitje me anë të analizës së ndeshjes. Programet e analizës mundësojnë grumbullimin e informacionit për të gjitha lëvizjet në ndeshje dhe me atë rast japin qasje të menjëhershme në informacionet që ne dëshirojmë në lidhje me ndeshjen. Gjithashtu, bën të mundur analizimin dhe vlerësimin e performancës fizike, teknike dhe taktike të futbollistit në ndeshje.

Ekzistojnë metoda të cilat bëjnë të mundur që kushtet e trajnimit dhe operacionet taktike në terren, të bëhen më efektive duke përcaktuar lidhjen midis shfaqjeve teknike dhe taktike të lëvizjes së atletëve, si dhe shfaqjeve fizike të atletëve gjatë ndeshjes.

Rezultatet e fituara nga analizat u jepen trajnerëve, me qëllim që ata të sigurojnë informacion të mjaftueshëm në lidhje me nivelin e efikasitetit të futbollistit dhe ekipit, gjithashtu u ndihmojnë që t'i përcaktojnë modelet e stërvitjes dhe vendimet personale që do të zbatohen në lojë.

Analiza e ndeshjes përdoret në zhvillimin dhe vlerësimin e performancës së ndeshjes duke përcaktuar programin e trajnimit. Informacioni i mbledhur mbi

bazën e të dhënave të grumbulluara ndihmon gjithashtu në krijimin e një standardi fiks për të krahasuar performancën e radhës.

**Në kapitullin e dytë** kandidati përshkruan gjetjet e shkencëtarëve të ndryshëm në lidhje me çështjet e parashtruara në këtë studim.

Armatas, duke analizuar golat e shënuar në Kupat e Botës për nga aspekti kohor, erdhi në përfundim se: shumica e golave të shënuar në Kupat e Botës në vitet 1998, 2002 dhe 2006 ndodhën në mes minutave 76-90. Ndërsa sa i përket shtrirjes së golave nëpër kohë në tre kampionate, rezultoi se 60.8% e golave ndodhën në Kupën e Botës të vitit 1998, 59% në Kupën e Botës 2002 dhe 52.5% në Kupën e Botës 2006, dhe të gjitha këto kryesisht në pjesën e dytë të lojës.

Orhani, një studiues tjetër deklaroi se në Kampionatin Evropian të Futbollit të vitit 1996, 27% e golave të shënuar u përqendruan në 15 minutat e fundit (edhe atë midis minutave 76 dhe 90).

Në një studim tjetër, Çakıroğlu deklaroi se në Superligën Turke është karakteristike se edhe ekipet fituese por edhe ata humbëse, më të suksesshëm në sulm janë në pjesën e dytë të lojës, ndërsa në Ligën e Kampionëve ai përcaktoi se sulmet më të suksesshme ndodhnin kryesisht në minutat 76-90.

Në një studim tjetër, Eniseler i analizoi 39 ndeshjet e zhvilluara nga Bergamaspor, që paraqet një nga ekipet e Ligës së Tretë Profesionale Turke të Futbollit, në sezonet 1992-1993 dhe 1993-1994 dhe përcaktoi se 26.1% e golave për sa i përket zonës së sulmit ndodhën si rezultat i sulmeve qendrore.

Një studim të ngjashëm bënë edhe, M. Hughes dhe I. Franks të cilët ekzaminuan numrin e pasimeve në dy kampionate të Kupës së Botës edhe atë të vitit 1990 dhe vitit 1994. Nga ky ekzaminim përcaktuan se 84% e totalit të pasimeve në Kupën e Botës së vitit 1990 dhe 80% të totalit të pasimeve në Kupën e Botës 1994 u bënë me 4 pasime ose më pak. Çakıroğlu, hulumtimin e tij e fokusoi në analizën krahasuese të organizimit të sulmeve të aplikuara në ndeshjet e futbollit të Superligës Turke dhe shqyrtimin e efekteve të tyre në rezultatet e ndeshjeve; Kur u shqyrtuan zonat ku gjuajtjet përfunduan si sulme të suksesshme midis Superligës

Turke dhe Ligës së Kampionëve, u përcaktua se shkalla e goditjeve nga brenda zonës së penalltisë prej (56%) ishte më e lartë në Superligën Turke, dhe shkalla e gjuajtjeve jashtë zonës së penalltisë prej (54%) ishte në Ligën e Kampionëve.

**Në kapitullin e tretë** jepen shpjegime në lidhje me metodën e hulumtimit. Hulumtimi është i bazuar kryesisht në metodën sasiore të mbledhjes së të dhënave të bazuara në vëzhgim, duke u fokusuar në vëzhgimin e performancës. Lënda e studimit përbëhet nga të gjithë golat e shënuar në gjithsej 2628 ndeshje të luajtura në Premier Ligën Angleze, Serie A të Italisë, La Liga Spanjolle, Super Liga Turke, Bundesliga Gjermane edhe atë në gjysmën e parë të sezonit 2016-2017, si dhe në sezonin e plotë 2017-2018 dhe 2018-2019.

Meqenëse e gjithë popullata kërkimore u përfshi në hulumtim, marrja e mostrave nuk u aplikua. Një total prej 7192 golash, që e përbëjnë universin kërkimor, u analizuan dhe u morën si të dhëna për studimin. Testi Cramer V dhe Hi-katrori ( $X^2$ ) u përdorën për të përcaktuar ndryshimet që rezultojnë në gola midis ligave të ndryshme në sezone të ndryshme edhe atë: ligat e Anglisë, Italisë, Spanjës, Turqisë, Gjermanisë gjysmën e parë të sezonit 2016-2017, si dhe në sezonin e plotë 2017-2018 dhe 2018-2019. Statistikat e Kappa-s ( $\kappa$ ) u përdorën për të përcaktuar besueshmërinë ndërvëzhguese. Për të përcaktuar besueshmërinë ndërvëzhguese, për bazë u analizuan 50 gola të rastësishëm nga 2 analistë të cilët morën pjesë në studim. Ndërkohë për të pasur besueshmëri statistikore akoma më të lartë, e njëjta analizë e 50 golave të rastësishëm nga po të njëjtit analistë u bë edhe 6 javë më vonë.

Imazhet e ndeshjeve të futbollit u regjistruan nga platforma e analizës Wyscout. Programet e analizës së ndeshjeve, siç është E-Analiza me ndihmën e kompjuterit dhe T.F.F Supervisor – janë disa nga format që përdorën për të arritur pozicionet e dëshiruara në ndeshje më lehtë dhe në një kohë të shkurtër.

Kriteret e analizës u krijuan duke marrë parasysh kriteret e përdorura në studime të ngjashme në literaturë si dhe u përgatitën formularë analize tek të cilat sistemohen të dhënat e mbledhura. Pra regjistrimi i të dhënave u realizua format e lartpërmendura. Si rezultat i këtyre formave të përgatitura; kriteret e hulumtimit u

përcaktuan në 5 ndryshore, edhe atë: koha e golave të shënuar, stili i sulmit të golave të shënuar, zona e sulmit të golave të shënuar (zona e asistimit), numri i pasimeve në golat e shënuar dhe rajonet e golave të shënuar.

Statistika Kappa u përdor për të përcaktuar besueshmërinë midis dy variablave edhe atë, vëzhguesit dhe vëzhgimet. Kappa ka një vlerë që varion nga -1.0 në +1.0. Indeksi Kappa që rezulton afër +1 do të thotë që dy variablat tregojnë lidhshmëri "të përsosur" për të njëjtat të dhëna. Indeksi Kappa afër -1 do të thotë që të dy variablat nuk pajtohen në të njëjtat të dhëna "në mënyrë të përsosur" dhe në mënyrë të qëndrueshme. Niveli i besueshmërisë në 0.60 ose 0.70 tregon një lidhje të përgjithshme e cila konsiderohet si e mjaftueshme mes dy variablave (Wood, 2007; Nuendorf, 2002; Krippendorff, 1980).

**Në kapitullin e katërt** është prezantuar interpretimi i rezultateve dhe krahasimi i mostrave nga dy vendet e përzgjedhura për hulumtim. Ndashjet e shikuara me video programet e analizës, vlerësohen me metodën e shënimit të golave (evidentimit), duke i ndarë në ndryshore (variabla). Nga tabela 9, përfundojmë se më pak gola janë shënuar në minutën 45+, ndërkaq në mes të minutave 60-75, më shumë gola janë shënuar nga Anglia dhe Italia, kurse në mes të minutave 75-90, janë shënuar nga Spanja, Turqia dhe Gjermania. Nga tabela 9, përfundojmë se më pak gola janë shënuar në minutën 45+, ndërkaq në mes të minutave 60-75, më shumë gola janë shënuar nga Anglia dhe Italia, kurse në mes të minutave 75-90, janë shënuar nga Spanja, Turqia dhe Gjermania. Nga tabela 10, rezulton se sipas stileve të sulmit, golat më pak të shënuar në të gjitha vendet janë ato me gjuajtje, ndërkohë, golat më të shënuar dukshëm janë ato që vijnë nga sulmet të shpejta. Për më tepër, numri i golave të shënuar me topin në lojë është dukshëm më i lartë.

Nga tabela 11, rezulton se të gjitha ligat pa përjashtim, zona e qendrës është ajo prej nga janë shënuar më shumë gola.

Kur shqyrtohet tabela 12, shihet se për të gjitha vendet, më së shumti gola janë shënuar me 0 pasime, dhe më pak gola janë shënuar me 7 pasime ose më shumë. Pra, është përcaktuar se numri i golave të shënuar rritet me uljen e numrit të pasimeve.



Kur shqyrtohet tabela 13, shihet se golat më të shënuar janë nga rajoni i dytë në të gjitha vendet. Gjithashtu është përcaktuar se rajoni ku shënohen më pak gola është rajoni i parë, përveç Anglisë. Nga shqyrtimi i tabelës 14, rezulton që më pak gola janë shënuar në minutat 45+, midis Anglisë dhe Italisë më shumë gola janë shënuar në mes të minutave 45-60, në mes të minutave 75-90 në ligën Spanjës, ndërsa mes minutave 15-30 në atë të Turqisë dhe Gjermanisë.

Tabela 15 paraqet stilet e sulmit. Nga kjo paraqitje konkludojmë se golat më pak të shënuar në të gjitha vendet janë me gjuajtje, ndërsa, në bazë të këtyre kriterëve sulmet e shpejta janë paraqitur të jenë forma më e mire e sulmit. Për më tepër, numri i golave të shënuar me driblim është dukshëm më i lartë. Nga shqyrtimi i tabelës 16, rezulton që rajoni prej ku janë shënuar më shumë gola, pa përjashtim në të gjitha ligat e kampionateve, është rajoni i qendrës.

Kur shqyrtohet tabela 17, shihet se për të gjitha vendet pa përjashtim, më së shumti gola janë shënuar me 0 pasime, dhe më pak gola janë shënuar me 7 pasime ose më shumë. Është vërtetuar se numri i golave të shënuar rritet me uljen e numrit të pasimeve. Nga tabela 18, shihet se golat më të shënuar janë nga rajoni i dytë në të gjitha vendet. Është përcaktuar se rajoni ku shënohen më pak gola është nga rajoni i parë, me përjashtim të ligës italiane.

Tabela 19 na paraqet se më pak gola të shënuar ka në minutat 45+ ndërkaq, golat më të shënuar janë mes minutave 45-60 midis Spanjës, Gjermanisë dhe Italisë, dhe në mes 75-90 minutave midis Anglisë dhe Turqisë. Nga tabela 20, konkludojmë se sipas stileve të sulmit më pak gola të shënuar në të gjitha vendet janë ato me gjuajtje, ndërkaq më shumë të tillë janë shënuar në stilin e sulmit të shpejtë. Kur u analizua tabela 21, u përcaktua se rajoni i asistimit ishte rajoni i qendrës në shumicën e golave të shënuar.

Kur shqyrtohet tabela 22, shihet se më shumë gola shënohen me 0 pasime, dhe më pak gola shënohen me 7 pasime ose më shumë. Pra, numri i golave të shënuar rritet me uljen e numrit të pasimeve. Nga Tabela 23, shihet se golat më të shënuar janë nga rajoni i dytë në të gjitha vendet, i cili ndiqet më pas nga rajoni i katërt.

**Në kapitullin e pestë** janë prezantuar diskutimet dhe krahasimet e rezultateve me punime të ndryshme, është paraqitur vërtetimi i hipotezave dhe përfundimet nga rezultatet. Koha e sulmit - Në 5 liga, asnjë ndryshim domethënës nuk u gjet midis gjysmave të para të sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019 për sa i përket kohës së sulmit që rezulton me gola ( $\chi^2 (14) = 20.509, p = 0.825 > 0.05$ ), Pra, hipoteza I hidhet poshtë (Tabela 24). Koha e sulmit (Klasifikimi Special) - Asnjë ndryshim domethënës nuk u gjet midis sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019 në të 5 ligat për sa i përket kohës së sulmit (në të dy gjysmat e lojës) që rezulton me gola ( $\chi^2 (2) = 2.454, p = 0.293 > 0.05$ ), Pra, hipoteza I refuzohet (Tabela 25). Forma e sulmit (Klasifikimi i përgjithshëm) - Në të 5 ligat për sa i përket stileve të sulmit që rezultuan në gola ( $\chi^2 (16) = 84.906, p = 0.00 < 0.05$ ), u gjet një lidhje e rëndësishme mes sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019. Pra, hipoteza e dytë pranohet (Tabela 26). Madhësia e efektit të këtij ndryshimi rezultoi të jetë  $V = 0.07$ , duke treguar lidhshmëri të fortë. Pra, është përcaktuar se stili sulmues ka një ndikim të madh në sezonin kur është luajtur ( $V = 0.49$ ). Në sezonet 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019, sulmet që rezultuan me gola në të gjitha ligat, janë si vijon – sulmet që përfundojnë më së shumti në gola janë ato me sulm të shpejtë edhe atë me 29.2%, pason sulmi me topin në lojë me 19.9%, në fund janë sulmet me goditje të lirë me 6.6%. Forma e sulmit (Klasifikimi special) - Në të gjitha ligat, midis sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019 asnjë ndryshim i rëndësishëm nuk u gjet sa i përket stileve të sulmit që rezultuan në gola ( $\chi^2 (2) = 2.309, p = 0.315 > 0.05$ ), (Tabela 27). Zonat e sulmit - Nuk u gjet ndonjë lidhje domethënëse në të gjitha ligat midis sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019, në aspektin e rajoneve (zonave) të sulmit që rezultonin në gola ( $\chi^2 (4) = 7.899, p = 0.095 > 0.05$ ). Pra, hipoteza e tretë refuzohet (Tabela 28.). Numri i pasimeve që përfundojnë në gol - Në të pesë ligat midis sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019 u gjet një lidhshmëri signifikante për sa i përket numrit të pasimeve të kryera që rezultojnë në gola ( $\chi^2 (16) = 52.105, p = 0.00 < 0.05$ ). Pra, hipoteza e 4 pranohet (Tabela 29). Madhësia e efektit të kësaj lidhjeje u gjet të jetë  $V = 0.60$ , kjo tregon se lidhja e variablave ka një efekt të fortë. Në të 5-të ligat, sulmet që rezultojnë me gol janë kryesisht 31.3% me 0 pasime

dhe 17.7% me 1 pasim. Nga analiza u përcaktua se 13.3% e golave rezultojnë me 2 pasime, 12.6% me 3 pasime, 10.8% me 4 pasime, 6.5% me 5 pasime 4.1% me 6 pasime, 2.3% me 7 pasime, 0.9% me 8 pasime (Grafiku 85). Rajonet prej ku shënohet goli - Nuk u gjet ndonjë lidhje domethënëse në të gjitha ligat midis sezoneve 2016–2017, 2017–2018 dhe 2018–2019, në aspektin e rajoneve (zonave) sulmet rezultuan në gola ( $p = 0.948 > 0.05$ ). Pra, hipoteza e pestë refuzohet (Tabela 30). Në të gjitha ligat, u vërtetua se në bazë të rajonit (zonës) prej ku u shënuan golat të shtrirë në sezone ishin si vijon, në sezonin %86, 6 në 2016–2017, %88.4 në 2017–2018 dhe %86.7 në 2018–2019. Gjithashtu shumica e sulmeve ishin penallti. (Grafiku 86).

**Në kapitullin e gjashtë**, është analizuar mostra e studimit që përbëhet nga 5 liga, përkatësisht Premier Liga Angleze, Serie A Italiane, La Liga Spanjolle, Super Liga Turke dhe Bundesliga Gjermane, edhe atë gjysma e sezonit 2016-2017, si dhe sezonat e plota 2017-2018 dhe 2018-2019. Analizën do ta bëjmë duke i krahasuar rezultatet e mostrës sonë me studime të tjera të ngjashme. Koha e sulmit - Për sa i përket variablës së kohës së sulmit që rezulton në gol, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota të 2017-2018 dhe 2018-2019, nuk u gjet asnjë e dhënë që kishte domethënie të rëndësishme statistikore, pra rezultati ishte ( $p=0,825>0,05$ ). Në të gjitha ligat, më shumë gola (17.2%) janë shënuar në mes të minutave 76-90, si dhe (16.7%) e sulmeve që kanë përfunduar në gol kanë qenë ato në mes të minutave 61-75 (Grafiku 77). Në një studim të ngjashëm është evidentuar gjithashtu se më shumë gola të shënuar në UEFA Champions League, janë shënuar në mes të minutave 76-90, pra në gjysmën e dytë të ndeshjes (54). Gjithashtu, në një studim tjetër të ngjashëm, rezulton që në ligën e parë, shumica e golave apo 24.8% prej tyre shënohen në pjesën e dytë të ndeshjes, edhe atë, në mes të minutave 76-90 (24). Armatas e ka bërë analizën e golave të shënuar në kampionatin e Kupës së Botës dhe ka konkluduar se në Kupën e Botës së vitit 1998, 60.8% e golave janë shënuar në mes të minutave 76-90. Në atë të 2002, 59% të golave janë shënuar në mes të minutave 76-90, dhe në kampionatin e 2006, 52.5% e golave janë shënuar në mes të minutave 76-90. Me pak fjalë, shumica e golave janë shënuar në pjesën e dytë të ndeshjes (2). Orhan analizoi se në kampionatin evropian të futbollit të vitit

1996, 27% e golave të shënuar u përqendruan në 15 minutat e fundit (midis minutave 76 dhe 90) (36). Në një studim të Çakırollut mbi Super Ligën Turke veçohet se të gjitha ekipet pa përjashtim, pra edhe ato fituese edhe ato humbëse, më shumë sulme që përfundojnë në gol e kanë në pjesën e dytë të ndeshjes, pra në mes minutave 75-90 (12). Sipas raporteve teknike të UEFA Champions League, në sezonin 2018-2019, 207 nga 366 golat e shënuar në Ligën e Kampionëve u shënuan në gjysmën e dytë të ndeshjes (59).

Këto rezultate janë të ngjashme me rezultatet e studimit tonë. Forma e sulmit - Për sa i përket variablës së formës së sulmit që rezulton në gol, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019, u gjet lidhje e rëndësishme statistikore, me një rezultat ( $\chi^2(16) = 84.906, p = 0.00 < 0.05$ ). Ndaj dhe hipoteza e dytë u pranua. Madhësia e efektit të kësaj lidhjeje rezultoi  $V = 0.07$ , duke treguar një efekt të fortë. Pra me këtë e përcaktojmë se forma e sulmit ka një ndikim të madh në shënimin e golit, me një rezultat prej ( $V = 0.49$ ).

Në të gjitha ligat, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota të 2017-2018 dhe 2018-2019, më shumë gola apo 29.2% të golave janë shënuar me topin në sulm, 19.9% me driblim dhe 9.2% me lojë (gjuajtje) individuale. Vetëm 9.05% e golave janë shënuar me anë të penaltisë, 6.6% me gjuajtje të lirë dhe 6.5% prej tyre me gjuajtje nga këndi. Nga një studim i ngjashëm i UEFA-s, më shumë gola u shënuan kur topi ishte në sulm. Ashtu që në sezonin 2004-2005, më shumë gola apo 25.15 prej tyre u shënuan me anë të sulmit të shpejtë, në sezonin 2005-2006 18.2% e golave u shënuan me të njejtën formë, pra me sulm të shpejtë, 18.2% me gjuajtje të lirë ndërsa në sezonin 2006-2007, me gjuajtje të shpejtë u shënuan 21.7% të golave, 17.5% me sulm të strukturuar dhe 16.8% me goditje. Rajonet e sulmit (Zona e asistimit): sa i përket, variablës së rajoneve (zonave) të sulmit që rezulton në gol, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019, nuk u gjet asnjë e dhënë që kishte domethënie të rëndësishme statistikore, pra rezultati ishte ( $p=0,095 > 0,05$ ). Në të 5-të ligat, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota të 2017-2018 dhe 2018-2019 më shumë gola janë shënuar nga zona e qendrës edhe atë 64.7%. Nga krahu i majtë janë shënuar 19.2% dhe vetëm 16.1% nga krahu i majtë. Numri i pasimeve që rezultojnë në gol

- Për sa i përket variablës së formës së sulmit që rezulton në gol, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019, u gjet lidhje e rëndësishme statistikore, me një rezultat ( $\chi^2(16) = 52.105, p=0,00 < 0,05$ ). Ndaj dhe hipoteza e katërt u pranua (Tabela 29). Madhësia e efektit të kësaj lidhjeje rezultoi  $V = 0.60$ , duke treguar një efekt të fortë. Pra me këtë përcaktojmë se numri i pasimeve gjatë sulmit ka një ndikim të madh në shënimin e golit, me një rezultat prej ( $V = 0.60$ ). Në të gjitha ligat, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019, 31.3% e golave ishin me 0 pasime dhe vetëm 17.7% me 1 pasim. Zonat e golit - Për sa i përket, variablës së rajoneve të golit, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019, nuk u gjet asnjë e dhënë që kishte domethënie të rëndësishme statistikore, pra rezultati ishte ( $p=0,0948 > 0,05$ ). Në të gjitha ligat, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota të 2017-2018 dhe 2018-2019, në rajonin 1 janë shënuar 4.9% e golave, në rajonin 2 - 76.7%, në rajonin 3 - 5.4% dhe në rajonin 4 janë shënuar 12.7% e golave. Kur u analizuan sulmet që rezultuan me gola në të gjitha ligat, u përcaktua se golat u shënuan kryesisht nga brenda zonës së penalltisë edhe atë në gjysmën e sezonit 2016-2017 (86.6%), 2017-2018 (88.4%) dhe 2018-2019 (86.7%).

**Në kapitullin e shtatë dhe si përfundim** - Pas analizës së të dhënave, sa i përket kriterit (variablës) të kohës së sulmit që rezulton në gol të shënuar, në ligat e Anglisë, Italisë, Spanjës, Turqisë dhe Gjermanisë, në gjysmën e sezonit 2016-2017, si dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe 2018-2019 u përcaktua se në ligën angleze dhe italiane më shumë gola u shënuan në mes të minutave 60-75, ndërsa në ligën spanjolle, turke gjermane më shumë gola u shënuan në mes të minutave 75-90. Po të analizohen format e shënimit të golave, rezulton se tek të gjithë ligat, më shumë gola janë shënuar me topin në sulm, dhe me sulm të shpejtë.

Në sezonin futbollistik 2017-2018, në ligat e Anglisë, Italisë, Spanjës, Turqisë dhe Gjermanisë më pak gola u shënuan në pjesën e parë të ndeshjes. Ndërsa më shumë mes minutave 45-60 Anglia dhe Italia, 75-90 Spanja dhe Turqia, ndërkohë Gjermania për dallim nga të tjerat në mes 15-30 minutave.

Në sezonin futbollistik 2018-2019, në ligat e Anglisë, Italisë, Spanjës, Turqisë dhe Gjermanisë më pak gola u shënuar në pjesën e parë të ndeshjes. Ndërsa më shumë mes minutave 45-60 Spanja, Gjermania dhe Italia, 75-90 Anglia dhe Italia.

Për sa u përket të dhënave që e tregojnë kriterit (variablën) e kohës së sulmit, u përcaktua se më shumë gola u shënuar në pjesën e dytë dhe pjesën e dytë të pjesës së parë. Këto të dhëna që merren nga kjo variabël do të shërbejnë si një faktor ndihmues në aftësimin e trajnerëve për të punuar në planet e tyre teknike, taktike gjatë sesioneve stërvitore.

Sipas stileve të sulmit, golat më pak të shënuar në të gjitha vendet janë ato me gjuajtje nga këndi, ndërkaq golat më shumë të shënuar në të gjitha vendet janë ato me sulme të shpejta. Kur analizohet zona prej ku sulmet përfundojnë në gol, dukshëm zona qendrore dominon në këtë drejtim. Për këtë arsye, mendohet se aplikimi i elementeve sulmuese si mbajtja e topit dhe vrapimi, driblimi, kalimi i ndërmjetëm, kryqëzimi dhe vrapimet mashtruese do të ndikojnë pozitivisht në suksesin dhe në metodat e stërvitjes, veçanërisht në përforcimin e sulmit dhe organizimin e mbrojtjes, kundrejt sulmeve kundërshtarë.

Sipas kriterit të numërimit të pasimeve, shihet se më së shumti gola shënohen me "0 pasime" dhe më pak gola shënohen me "7 pasime" ose më shumë, në të gjitha ligat kombëtare. Vlen të përmendet se me zvogëlimin e numrit të pasimeve, numri i golave të shënuar rritet.

Nga analiza e të dhënave sa i përket kriterit të numrit të pasimeve, u përcaktua se sulmet që rezultuan me gola të shënuar, në ligat si ajo e Anglisë, Italisë, Spanjës, Turqisë dhe Gjermanisë, ndodhën kryesisht midis 0-5 pasimeve.

Gjatë krijimit të modelit të trajnimit, mendohet se marrja parasysh e këtyre të dhënave në përzgjedhjen e ushtrimeve të përshtatshme do të ndikojë pozitivisht në sukses. Sipas kriterëve të rajoneve të sulmit shihet se golat më të shënuar në 5 ligat janë nga rajoni i dytë. Gjithashtu, është evidentuar se pas rajonit të dytë, me më shumë gola të shënuar është rajoni i katërt. Si rezultat i të dhënave dhe hulumtimeve të tjera që kemi marrë sa u përket kriterëve të zonave nga ku shënohen golat dhe kur u ekzaminuan sulmet që rezultuan me gola në të gjitha ligat, u përcaktua se

golat u shënuan kryesisht nga brenda zonës së penaltisë (Zona e dytë). Shihet se shkalla e golave të shënuar brenda zonës së penaltisë është dukshëm më e lartë se shkalla e golave të shënuar jashtë zonës së penaltisë. Për këtë arsye, duke marrë parasysh këto raporte, duhet të aplikohen modele stërvitore ku do të ushtrohen goditje kryesisht nga brenda zonës së penaltisë. Mendohet se studimi do të funksionojë si një element ndihmës në planifikimin e trajnimit.


Përfundimi dhe propozimi nga komisioni

Punimi i disertacionit të doktoraturës me titull: "Analiza e golave të shënuar në Premier Ligën Angleze, Serie-A Italiane, La Ligën Spanjolle, Superligën turke dhe Bundesligën Gjermane në gjysmën e parë të sezonit 2016-2017, dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe të 2018-2019" i kandidatit Dr Aytakin Sonmeyer-makas, sjell një hulumtim shkencor të ndërlidhur në mes fushës së shkencave sportive. Përmes analizave statistikore dhe rezultateve të fituara nga ky hulumtim shkencor në lëmin e shkencave e sportive, kandidati paraqet punën hulumtuese dhe ofron një kontribut shkencor në kuadër të kësaj fushe. Ky hulumtim hap rrugë për realizim të hulumtimeve tjera të ngjashme në këtë fushë për dy vendet e përfshira në hulumtim.

Në bazë të raportit të përshkruar më lart, Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull "Analiza e golave të shënuar në Premier Ligën Angleze, Serie-A Italiane, La Ligën Spanjolle, Superligën turke dhe Bundesligën Gjermane në gjysmën e parë të sezonit 2016-2017, dhe në sezonet e plota 2017-2018 dhe të 2018-2019" i kandidatit Dr Aytakin Sonmeyer-makas, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara dhe i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës që të aprovojë këtë raport të vlerësimit të disertacionit të doktoraturës dhe të lejojë mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof.Dr. Haki Isamili – kryetar
2. Prof.Dr.Shpresa Memishi - anëtar
3. Prof.Dr. Besnik Telai- anëtar
4. Prof.Dr. Vullnet Ameti - anëtar
5. Prof. Dr. Metin Dalip -anëtar

The image shows five handwritten signatures in blue ink, arranged vertically. The signatures are stylized and cursive, corresponding to the list of names provided to the left. The first signature is the most prominent and appears to be the signature of the chairperson, Haki Isamili.

Tetovë, 2021